



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL

FTESË PËR NEGOCIATA

Të nderuar,

Mbështetur në VKM nr. 719, datë 31.10.2014, “Për funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, si Agjenci e Pagesave”, i ndryshuar, në VKM nr. 1195, datë 05.08.2008, “Për blerjen, zhvillimin, prodhimin e bashkëprodhimin e programeve a të reklamave për transmetim nga operatorët radioteleviziv ose botim në median e shkruar, dhe për kontratat, për kohë transmetimi, nga organet e administratës shtetërore”, në VKM nr. 125, datë 01.03.2023, “Për përcaktimin e kritereve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2023”, si dhe në Udhëzimin nr. 5, datë 03.03.2023, “Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”,

Objekti i programit/spotit/reklamës: Informimi mediatik i publikut lidhur me masat e mbështetjes së programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, për vitin 2023

Nevoja për kryerjen e reklamave: Me anë të kësaj fushate komunikimi do të bëhet i mundur realizimi i objektivit: “Për aktivitetet informuese për publikun lidhur me masat e mbështetjes nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2023”, dhe marrja e informacionit në të gjithë territorin e vendit me fokus kryesore zonat rurale.

Të zhvillohet procedura e blerjes, zhvillimit dhe prodhimit të spotiteve/reklamave: “Për informimin mediatik të publikut të gjerë, lidhur me implementimin e masave të mbështetjes për vitin 2023” me fond limit 19.800.000 (nëntëmbëdhjetë milion e tetëqind mijë) lekë pa TVSH.

Ideimi i spoteve/video informuese të kryhet nga organet e masmedias të specializuara në këtë fushë dhe transmetimi të kryhet nga masmedia on-line 1 (një) Spot i përgjithshëm për Skemën Kombëtare 2023, 9 Video (motion graphic), Fletëpalosje, Printim posterash, Poster (banner), Grafik Printim, Roll up, Reklamim «radio», Reklamim në rrjetin social (facebook), Publikimi i skemave mbështetëse për vitin 2023 në median e shkruar, Organizimi i takimeve informuese me fermerë.

1. Objekti i programit të spoteve/reklamave për sektorët që do të mbështeten, nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, është si më poshtë:

- a) rritjen e konkurrueshmërisë së prodhimeve blegtorale dhe të prodhimeve bujqësore në mjedise të mbrojtura, duke ulur kostot nëpërmjet pagesave për kafshë të matrikulluara, si dhe për sipërfaqe të kultivuar;
- b) certifikimin e produkteve bujqësore dhe fermave organike;
- c) ndërtimin e tregjeve të produkteve bujqësore dhe tregjeve të kafshëve të gjalla në disa bashki të vendit;
- d) përmirësimin e efijencës energjetike dhe përshtatjen e kapaciteteve të peshkimit me burimet peshkore;
- e) mbështetjen me naftë për bujqësinë për kryerjen e punimeve të mekanizuara në kulturat bujqësore;
- f) mbështetjen për trajnimin dhe transferimin e njohurive në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural.

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural shpall thirrjen për aplikime nga fondi i Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, për vitin 2023.

Aplikimi për masat direkte dhe për masat e investimeve do të bëhen nga data 20.03.2023 deri më 11.04.2023.

Bazuar në VKM nr. 125, datë 01.03.2023, “Për përcaktimin e kritereve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2023”, sektorët që do të mbështeten dhe masa e financimit për vitin 2023, për:

Masat e mbështetjes dhe masa e financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural janë, si më poshtë vijon:

2.1. Bujqësia, blegtoria dhe peshkimi

- a) Për tufën bazë të matrikulluar (kafshët riprodhuese), për fermat me jo më pak se 10 (dhjetë) krerë lopë, në vlerën deri në 10 000 (dhjetë mijë) lekë/krerë, por jo më shumë se 500 000 (pesëqind mijë) lekë për subjekt;
- b) Për tufën bazë të matrikulluar (kafshët riprodhuese), për fermat me jo më pak se 100 (njëqind) krerë dele dhe/ose dhi, në vlerën deri në 1 200 (njëmijë e dyqind) lekë/krerë, por jo më shumë se 360 000 (treqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë për subjekt;
- c) Mbarështim i bletarisë në vlerën deri në 1 000 (një mijë) lekë për zgjua, për ferma me jo më pak se 50 (pesëdhjetë) zgjoje, por jo më shumë se 150 000 (njëqind e pesëdhjetë) mijë lekë për subjekt;
- ç) Mbështetje për fara/fidanë dhe impute të tjera, në vlerën deri në 200 000 (dyqind mijë) lekë për ha për sezon dhe jo për më shumë se 2 sezone, për kultivimin e perimeve, rrushit për tavolinë në serra dhe/ose luleshtrydhe në tunele plastike për fermerë individualë ose grup fermerësh, me sipërfaqe të mbjellë jo më pak se 1 (një) ha dhe jo më shumë se 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë për aplikant;
- d) Fermat organike për periudhën në kalim, vitin e parë, në vlerën 100 000 (njëqind mijë) lekë, në vitin e dytë 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, vitin e tretë 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë dhe 200 000 (dyqind mijë) për fermë të certifikuar;
- dh) Implementimi dhe certifikimi global GAP, në perime, fruta, rrush, ullinj, agrume dhe kultura të tjera bujqësore të certifikueshme, në masën 50 (pesëdhjetë) % të vlerës totale të faturës

tatimore: i. por jo më shumë 175 000 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë, në sipërfaqe jo më pak se 1 (një) ha; ii. por jo më shumë se 500 000 (pesëqind mijë) lekë, për sipërfaqe jo më pak se 3 (tre) ha në ambiente të mbrojtura dhe jo më pak se 10 (dhjetë) ha në fushë të hapur.

e) Për rinovimin e infrastrukturës së anijes së peshkimit, masa e përfitimit të jetë në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 13 500 000 (trembëdhjetë milionë e pesëqind mijë) lekë për anije peshkimi të pajisur me leje të vlefshme peshkimi tregtar dhe jo më shumë se 20 000 000 (njëzet milionë) lekë për subjekt. Rinovimi i anijes së peshkimit përfshin:

i. blerjen dhe instalimin e motorit kryesor, por jo më shumë se 7 000 000 (shtatë milionë) lekë;

ii. blerjen dhe instalimin e motorit ndihmës (gjeneratori detar), por jo më shumë se 1 000 000 (një milion) lekë;

iii. blerjen dhe instalimin e vinçit të anijes, por jo më shumë se 3 500 000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekë. Vinçi përfshin edhe agregatet, hidromotorin, pompë vaji friksion, multiplikator dhe tubacionet;

iv. blerjen dhe instalimin e kamios (koplunit), por jo më shumë se 3 000 000 (tre milionë lekë);

v. riparimin e përgjithshëm të anijes, por jo më shumë se 9 000 000 (nëntë milionë) lekë. Në riparimin e përgjithshëm, përveç zërave të përcaktuar në dokimin periodik, sipas nënpikës “vi”, përfshihen dhe zëvendësim llamarine ose ndërrim dërrase;

vi. Dokimin periodik të anijes, por jo më shumë se 3 000 000 (tre milionë) lekë. Dokimi periodik përfshin ngritjen dhe uljen nga kantieri, pastrimin dhe heqjen e bojës së vjetër, blerje boje, stuko, protektor (zinqe), riparim aksi helike.

Tregjet e produkteve bujqësore, tregjet e kafshëve të gjalla dhe thertoret Mbështetje për ndërtimin e tregjeve të produkteve bujqësore, tregjeve të kafshëve të gjalla ose thertoreve për shoqëritë tregtare me kapital 100% shtetëror, të zotëruara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, në vlerën jo më shumë se 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë për subjekt, nëpërmjet transferimit të fondit nga llogaria ekonomike 606 në llogarinë ekonomike 604 “Të tjera transferata të brendshme”. Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR) ekzekuton transferimin e fondit përkatës të bashkia përkatëse, e cila është përgjegjëse për menaxhimin e këtij fondi.

Mbështetje me naftë për punimet e mekanizuara

Mbështetje me naftë për kryerjen e punimeve të mekanizuara në bujqësi, në vlerën deri në 1 328 000 000 (një miliard e treqind e njëzet e tetë milionë) lekë.

Subjektet përfitues mbështeten me sasi naftë falas në barasvlerë të lehtësimit fiskal të naftës, që përdoret për kryerjen e punimeve të mekanizuara në kulturat bujqësore, sipas kriterëve dhe masës së përfitimit, të përcaktuara në këtë vendim.

Kulturat bujqësore/grup kulturat, normativat e konsumit të naftës dhe sasia respektive e naftës, që përfitohet falas, janë sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Çmimi referencë për naftën llogaritet nga çmimi i publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike, i Agjencisë së Prokurimeve Publike (rubrika “Të dhëna për karburantet), me burim informacioni Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

Subjektet përfitues duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

i. të kenë tokë bujqësore në pronësi dhe/ose në përdorim, të provuar me dokumentacionin përkatës;

ii. madhësia totale e fermës duhet të jetë me sipërfaqe jo më pak se 1 (një) ha, ndërsa madhësia e parcelave me sipërfaqe jo më pak se 0.1 ha.

2.3.5 Aplikimi për të përfituar nga masa e mbështetjes me naftë për bujqësinë, bëhet “on-line”, në portalin “e-Albania”, me vetëdeklarim.

2.3.6 Përfitimi i sasisë së naftës falas për sipërfaqen që kultivohet është, si më poshtë vijon: i. 100% e sasisë për subjektet me sipërfaqe deri në 10 ha, sipas përlllogaritjeve të bëra, referuar aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

ii. subjektet me sipërfaqe mbi 10 ha, për sipërfaqen deri në 10 ha, përfitojnë sasinë, sipas përcaktimit të nëndarjes “i”, të kësaj pike, ndërsa për pjesën tjetër mbi 10 ha përfitojnë sasinë e naftës me normativë të reduktuar. Normativa e reduktuar përlllogaritet bazuar në nevojat për naftë të subjekteve me sipërfaqe mbi 10 ha, por jo më shumë se normativa e lejuar, si dhe në sasinë e mbetur të naftës në 5 dispozicion, pasi janë plotësuar nevojat deri në 10 ha të të gjithë subjekteve, që janë kualifikuar si përfitues.

2.3.7 Aplikimet i nënshtrohen procesit të verifikimit/kontrollit administrativ dhe për aplikimet fituese kryhet kontrolli në terren. Procesi i kontrollit në terren kryhet pas shpërndarjes së naftës tek subjektet përfituese:

i. për të vlerësuar përputhshmërinë e vetëdeklarimeve me situatën reale dhe shmangien e lejuar të faktit të verifikuar të kulturave dhe të sipërfaqes së kultivuar, në raport me naftën e tërhequr, e cila të jetë jo më e madhe se 20%;

ii. në jo më pak se 10% të subjekteve përfituese, përfshirë kontrollin e gjitha subjekteve me sipërfaqe mbi 10 ha.

2.3.8 Çdo subjekt, që përfiton nga skema e mbështetjes me naftë për bujqësinë, me shmangie më të madhe se 20%, sipas përcaktimeve të pikës 2.3.7, nëndarja “i”, më sipër ose me deklarime/dokumente të pasakta, përjashtohet për 3 (tre) vjet nga e drejta e përfitimit prej masave mbështetëse për bujqësinë dhe zhvillimin rural, të financuara nga buxheti i shtetit. Subjektet me status fizik dhe juridik shpallen edhe debitor për vlerën e përfituar në mënyrë të padrejtë.

2.3.9 Nafta për bujqësinë do të shpërndahet nga operatorët furnizues të kontraktuar në bazë të përzgjedhjes, sipas procedurave ligjore prokuruese kuadër, nëpërmjet pikave të tyre të shpërndarjes në të gjithë vendin, ku fermerët paraqiten me kartën individuale, në të cilën është hedhur sasia e naftës që ka të drejtë të tërheqë fermeri përkatës. Procedura e prokurimit për blerjen dhe shpërndarjen e naftës për përdorim nga fermerët realizohet, në përputhje me legjislacionin në fushën e prokurimit publik. Likuidimi i pagesave për furnizuesit e kontraktuar të naftës bëhet në përputhje me sasinë e naftës së shpërndarë te përfituesit..

Thirrja për aplikime do të qëndrojë e hapur nga data 20.03.2023 deri më 11.04.2023.

Informacioni për mënyrën e aplikimit, kriteret e përfitimit dhe procedimit deri në përfitimin e mbështetjes financiare gjendet pranë Agropikave, pranë Agjencive Rajonale të Ekstensionit Bujqësor, Zyra e Qëndrore të AZHBR, si dhe në faqen e saj të internetit www.azhbr.gov.al.

Aplikimet për masat mbështetëse direkte me 1-6 dhe 9 do të bëhen on-line;

Aplikimi on-line bëhet mbi bazën e parimit “zero dokumente” në momentin e aplikimit;

Aplikimi on-line do të bëhet nga aplikanti në portalin e-Albania”.

Aplikantët kur e kanë të nevojshme gjatë procesit të aplikimit asistohen online, nëpërmjet numrit jeshil 08008383, nga specialistët e Agropika-ve, Agjencive Rajonale të Ekstensionit Bujqësor

Përfitues për masat mbështetëse të mësipërme mund të jenë fermerë individualë, grup fermerësh, persona fizik, juridik, SHBB;

Të gjithë aplikantët me status fermer ose person fizik/juridik që kryejnë aktivitet për prodhimin bujqësor dhe blegtoral, para aplikimit duhet të plotësojnë/përditësojnë Regjistrin e Fermës;

Procedura e aplikimit nga portali e-Albania, përfundon me dërgimin me sukses të formatit elektronik të formularit të aplikimit.

Renditja e aplikimeve bëhet automatikisht nga sistemi në rang kombëtar dhe për çdo masë mbështetëse.

Aplikimi on-line është i mundshëm përgjatë 24 orëve, nga ora 08.00, e datës së hapjes deri në orën 24:00, të datës së përfundimit të periudhës së aplikimit.

Aplikimi me dosje fizike në AZHBR

Aplikimet për masën mbështetëse të investimeve me nr. 7 dhe 8 do të bëhen me dosje në zyrat qendrore të AZHBR;

Për qëllime identifikimi, aplikanti sipas statusit përkatës (person fizik/juridik), ose përfaqësuesi i tij me prokurë ose autorizim, duhet të paraqitet në zyrat qendrore të AZHBR-së me letërnjoftim elektronik ose pasaportë biometrike.

- 1. TV – 1 (një) Spot i përgjithshëm për Skemën Kombëtare 2023, ku të jenë të cilësuar masat me aplikim online që kryhen nga vetë aplikanti nëpërmjet portalit e-Albania dhe masat me dorëzim dosje aplikimi në AZHBR qendër, jo më shumë se 1 minutë.**
 - Spoti do të transmetohet në TV Kombëtare, gjatë periudhës së thirrjes, nga data 17.03.2023 – 27.03.2023 (shpeshësia jo më pak se 4 herë në ditë, ku shikueshmëria është më e lartë).
 - Numri i spoteve (reklamave) me xhirime që do të realizohen, do të jetë 1 (një).
 - Operatori merr përsipër të krijojë konceptin, skenarin dhe storyboarding e spotit.
 - Spoti duhet të përmbajë xhirime cilësore (HD).
 - Regjistrimet dhe prodhimi i spotit duhet të përfshijë: sekuenca, plane detaje të përgjithshme, elemente grafike të shoqëruara me titra, pamje që tregojnë gjeografinë e vendndodhjes, filmime në lartësi, planë me dron etj.
 - Komplekse blegtorale kullota plane në perspektivë që tregojnë zhvillimin rural.
 - Pamje kodrinore apo fusha të mbjella me kultura bujqësore, peshkim dhe mjete bujqësore etj.
 - Sekuenca që tregojnë infrastrukturë të ngritur, pika grumbullimi etj.
 - Kohëzgjatja e transmetimit publik duhet të jetë 10 ditë (Transmetimet duhet të jenë gjatë audiencës maksimale para edicionit të lajmeve në TV kombëtare).
 - Audio dhe kolona zanore e spotit duhet të jenë cilësore me parametra 4/8khz dhe 24-bit depth.
 - Efektet audio dhe efektet muzikore që do të shoqërojnë spotet të zotërojnë të gjitha të drejtat e përdorimit pa limit në hapësirë gjeografike apo kohore.
 - Spoti do të shoqërohet me voiceover dhe/ose me titra.
 - Spoti duhet të shoqërohet me sloganin kryesor dhe logot zyrtare të MBZHR, AZHBR.

- Operatori siguron të gjithë infrastrukturën e nevojshme lëvizjet stafin dhe lejet për filmime në vendndodhje të ndryshme.
- Produkti final duhet të jetë format HD 1080, si dhe të dorëzohet në format Digital CD/USB.

Afati i dorëzimit të spotit, maksimumi 4 (katër) ditë nga Lidhja e Kontratës.

2. 9 Video Graphic

- 9 Video (motion graphic) 1 video për secilën masë, për përdorim në rrjete sociale
- Gjatesia e video graphic te jete jo me pak se 30 sekonda
- Me sfond muzikor dhe voiceover (nese kerkohet)
- Të përmbajë imazhe grafike shpjeguese sipas nevojës
- Videot duhet të përmbajnë sloganin kryesor, logon zyrtare të AZHBR, MBZHR, e-Albania, si dhe adresën e internetit përkatës.
- Produkti final duhet të jetë format video HD 1080, si dhe duhet të dorëzohet në format digital CD ose USB.

Afati i dorëzimit 5 (pesë) ditë nga nënshkrimi i kontratës.

3. Shërbimet, komponentët:

1. Fletëpalosje, katër faqe, 5.000 copë:

- a. 4 ngjyra
- b. Letër 115 gr

2. Printim posterash, 1 faqe, 50 copë:

- a. 4 ngjyra
- b. Letër 115 gr
- c. Format A3

3. Poster (banner) grafik për kryefaqen e ëeb-it zyrtar AZHBR:

- a. Dizajn me ngjyra
- b. Logo e AZHBR, MBZHR, E-Albania
- c. Përmasa sipas parametrave të dritares në faqen zyrtare AZHBR

4. Printim Roll up, 6 copë

- a. Përmasat 80 x 200 cm
- b. Material banner + mekanizëm përkatës
- c. Roll up do të përmbajë 1 dizajn.

5. Reklamim «radio»

- a. Prodhim i 1 spoti radiofonik
- b. Transmetimi i spotit radiofonik ne minimumi 1 radio kombëtare dhe 3 radio lokale (duke mbuluar të gjithë territorin e vendit dhe të vihet theksi që të informohen sa më shumë zonat rurale në vend)
- c. Frekuenca jo më pak se 4 herë në ditë.

6. Reklamim në rrjetin social (facebook) audiencia e synuar është 100.000 përdorues në ditë, dhe frekuenca e shfaqjes të jetë 2 herë në ditë.
7. Publikimi i skemave mbështetëse për vitin 2023, në median e shkruar minimumi 4 gazeta të përditshme, për 7 ditë.
8. Organizimi i takimeve informuese me fermere për aplikime në skemën mbështetëse kombëtare 2023 me të dhëna/specifikime si më poshtë:
 - Do të organizohen në total 12 (dymbëdhjetë) aktivitete në qarqet: Tiranë, Shkodër, Lezhë, Durrës, Fier, Berat, Vlorë, Elbasan, Korçë, Dibër, Gjirokastrë dhe Kukës;
 - Shërbimi kërkohet të jetë në ambient të hapur (outdoor) ose të mbyllur (indoor), duke respektuar rregullat dhe aktet ligjore e nënligjore të vendosura nga Institucionet për COVID 19,
 - Vendndodhjet e eventit:
 - të jetë për 80 persona të ulur (karrige të disponueshme);
 - të ketë të instaluar sistem audio, pajisje të nevojshme si dhe të ofrohen dhe dy mikrofona valor për diskutime nga të pranishmit.
 - asistencë teknike gjatë gjithë takimit.
9. Monitorimi i procedurës së ndjekur nga kompania e specializuar që ushtron këtë aktivitet dhe monitorimin e gjithë praktikës.

4. Termat e referencës

1. Fletëpalosje

- Operatori merr përsipër të krijojë, tekstin dhe layout-in grafik të fletëpalosjeve;
- Fletëpalosja duhet të përmbajë slogan tekst logo;
- Operatori merr përsipër shërbimin fotografik për fletëpalosjen;
- Fletëpalosja duhet të përmbajë logon e AZHBR MBZHR;

Afati i dorëzimit 5 (pesë) ditë nga nënshkrimi i kontratës.

2. Poster

- Operatori merr përsipër të krijojë konceptin tekstin dhe layout grafik të posterit, me kompozim të ndryshëm për masat mbështetëse
- Posterit duhet të përmbajë fotografi, slogan tekst
- Operatori merr përsipër shërbimin fotografik për posterin
- Posterit duhet të përmbajë logon e AZHBR, MBZHR.

Afati i dorëzimit 5 (pesë) ditë nga nënshkrimi i kontratës.

3. Roll up

- Operatori merr përsipër të krijojë konceptin tekstin dhe layout grafik të posterit, me kompozim
- Roll up do të përmbajë 1 dizajn
- Roll up duhet të përmbajë slogan tekst logo
- Operatori merr përsipër shërbimin fotografik për fletëpalosjen
- Roll up duhet të përmbajë logon e AZHBR MBZHR

Afati i dorëzimit 5 (pesë) ditë nga nënshkrimi i kontratës

4. Reklamimi ne Facebook me qëllim arrijten e 100.000 përdorues në ditë-shpeshësia e boost jo më pak se dy herë në ditë.
5. Organizimi i aktiviteteve:
 - Aktivitetet do të zhvillohen gjatë periudhës së muajit Mars 2023.
 - Operatori ekonomik merr përsipër transportin e materialeve të përcaktuara sa më sipër si karrige, banner, stafin e promocionit, blerjen e maskave mbrojtëse etj;
 - Operatori ekonomik merr përsipër organizimin e aktiviteteve përkatëse sipas specifikimeve teknike;
6. Vlera e kontratës së shërbimit do të jetë: jo më shumë se 40 % ideim, krijim prodhim dhe pjesa tjetër prej 60 % e mbetur do të jetë për transmetim sipas media planit.
7. Të paraqitet një projekt ide-skenar për realizimin e shërbimit në CD.
8. Monitorimi i gjithë procedurës së ndjekur nga kompania të specializuara që ushtrojnë këtë aktivitet .afati i realizimit të shërbimeve si më sipër do të jetë deri në përfundim të afatit të skemave kombëtare.

5. Termat e referencës

9. Fletëpalosje

- Operatori merr përsipër të krijojë, tekstin dhe layout-in grafik të fletëpalosjeve;
- Fletëpalosja duhet të përmbajë slogan tekst logo;
- Operatori merr përsipër shërbimin fotografik për fletëpalosjen;
- Fletëpalosja duhet të përmbajë logon e AZHBR MBZHR;

Afati i dorëzimit 5 (pesë) ditë nga nënshkrimi i kontratës.

10. Poster

- Operatori merr përsipër të krijojë konceptin tekstin dhe layout grafik të posterit, me kompozim të ndryshëm për masat mbështetëse
- Posterit duhet të përmbajë fotografi, slogan tekst
- Operatori merr përsipër shërbimin fotografik për posterin
- Posterit duhet të përmbajë logon e AZHBR, MBZHR.

Afati i dorëzimit 5 (pesë) ditë nga nënshkrimi i kontratës.

11. Roll up

- Operatori merr përsipër të krijojë konceptin tekstin dhe layout grafik të posterit, me kompozim
- Roll up do të përmbajë 1 dizajn
- Roll up duhet të përmbajë slogan tekst logo
- Operatori merr përsipër shërbimin fotografik për fletëpalosjen
- Roll up duhet të përmbajë logon e AZHBR MBZHR

Afati i dorëzimit 5 (pesë) ditë nga nënshkrimi i kontratës

12. Reklamimi në Facebook me qëllim arritjen e 100.000 përdorues në ditë-shpeshësia e boost jo më pak se dy herë në ditë.

13. Organizimi i aktiviteteve:

- Aktivitetet do të zhvillohen gjatë periudhës së muajit Mars 2023.
- Operatori ekonomik merr përsipër transportin e materialeve të përcaktuara sa më sipër si karrige, banner, stafin e promovimit, blerjen e maskave mbrojtëse etj;
- Operatori ekonomik merr përsipër organizimin e aktiviteteve përkatëse sipas specifikimeve teknike;

14. Vlera e kontratës së shërbimit do të jetë: jo më shumë se 40 % ideim, krijim prodhim dhe pjesa tjetër prej 60 % e mbetur do të jetë për transmetim sipas media planit.

15. Të paraqitet një projekt ide-skenar për realizimin e shërbimit në CD.

16. Monitorimi i gjithë procedurës së ndjekur nga kompania të specializuara që ushtrojnë këtë aktivitet .afati i realizimit të shërbimeve si më sipër do të jetë deri në përfundim të afatit të skemave kombëtare.

Vlera e kontratës së shërbimit do të jetë: jo më shumë se 40 % ideim, krijim prodhim dhe pjesa tjetër prej 60 % e mbetur do të jetë për transmetim sipas media planit.

Fondi limit është 19.800.000 (nëntëmbëdhjetë milion e tetëqind) lekë pa TVSH.

➤ **Dokumente ligjore që duhen paraqitur, si kriter kualifikues:**

- Ekstrakt historik i QKR, që vërteton se Operatori Ekonomik ushtron aktivitet ekonomik tregtar që përputhet me objektin e procedurës dhe është aktiv.
- Dokument nga organet kompetente që vërteton se operatori ekonomik ka shlyer detyrimet fiskale, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për periudhën koherente.
- Vërtetim të xhiros vjetore të realizuar gjatë 3 viteve 2019-2020-2021.
- Vërtetim për numrin e punonjësve për periudhën Janar 2022-Janar 2023.
- Vetëdeklarim mbi gjëndjen gjyqësore, ku shprehet se Operatori ekonomik nuk ka ndjekje penale, si dhe nuk është dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata, që lidhet me aktivitetin profesional.

➤ **Dokumentacioni financiar, si kriter kualifikues**

- Vërtetim nga banka për numrin e llogarisë bankare së bashku me nr. IBAN
- Kontratë të ngjajshme të realizuar gjatë tre viteve të fundit me shtetin (referencë ose kontratë) dhe/ose me subjekte private (faturat përkatëse dhe/ose kontrata).
- Sigurimin e ofertës në masën 2% të vlerës së fondit limit;
- Deklaratën që subjekti nuk është në konflikt interesi;
- Deklaratën që i përmbush specifikimet dhe termat e referencës, deklaraten e konfidencialitetit;

- Formularin e ofertës;
- Media plan paraprak për shpërndarjen/transmetim;
- Deklaratë nga operatori ekonomik që transmetimi i reklamës do të jepet nga organet e medias, të cilat janë aktive dhe të licensuara sipas legjislationit në fuqi.

Dokumentacioni të jetë origjinal ose kopje e noterizuar dhe duhet të jetë lëshuar brenda tre muajve nga data e zhvillimit të procedurës.

Kriteret e vlerësimit të subjekteve janë :

Vlerësohet me 35 (tridhjetë e pesë) pikë; Projekt-ideja e realizimit të spoteve/reklamave, e cila përmban idejim/krijim, regji, montazh, efekte vizive dhe audio, stafi aktorëve, stafi ndihmues, etj.

Projekt ideja do të vlerësohet nga Komisioni, në varësi të projekt idesë më të mirë të paraqitur.

Vlerësohet me 30 (tridhjetë) pikë; Koha televizive e blerë për transmetimin e Spoteve/reklamave (sipas logjikës së formulës më poshtë).

KT- Koha Televizive

KTM- Koha televizive me e madhe

KTV- Koha Televizive e që vlerësohet

$$KT = \frac{30 * KTV}{KTM}$$

Vlerësohet me 35 (tridhjetë e pesë) pikë; oferta më e ulët ekonomike në përputhje me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta (sipas logjikës së formulës më poshtë).

OE- Oferta ekonomike

OU- Oferta më e ulët

OV- Oferta që vlerësohet

$$OE = \frac{35 \times OU}{OV}$$

Vlerësimi përfundimtar = pikët për projekt idenë + pikët për Kohën televizive + pikët për ofertën ekonomike.

Oferta duhet të jetë origjinale si dhe dokumentacioni i kërkuar më sipër duhet të jenë të futur në zarf jo transparent, të mbyllur, të vulosur dhe të firmosur me emrin dhe adresën tuaj.

Mbi zarf të jetë shënuar “**Ftesë për negociatë**”. Përzgjedhja e ofertave do të realizohet sipas VKM nr. 1195, datë 5.8.2008, dhe kriterve të përshkruara dhe metodologjisë me sistemin e pikëve.

Monitorimi i publicitetit do të kryhet sipas përcaktimeve që do të vendosen në kontratën e shërbimit ndërmejt palëve.

Ofertat duhet të jenë të mbyllura në zarf, të vulosura dhe do të dorëzohen nga përfaqësuesit e shoqërive zyrtarisht pranë AZHBR në datën **13.03.2023, ora 12:00**.

Në procesin e hapjes së ofertave kanë të drejtë të marrin pjesë Ofertuesit, apo personat me autorizim.

Komisioni pret konfirmimin nga organet e masmedias/të Agjencive të specializuara për vazhdimësinë e negociatave, brenda afatit të fundit të paraqitur në ftesën për negociata.

Komisioni nuk do të pranojë asnjë ofertë jashtë këtij afati dhe jo në përputhje me kërkesat e mësipërme.

Pas analizimit të ofertave, të paraqitura nga organet e masmedias/agjencitë e specializuara, komisioni përzgjedh, në bazë të pikëve, organet e masmedias/agjencitë e specializuara, duke u bazuar në kushtet e veçanta, të përcaktuara.

Ju falemnderit për bashkëpunimin.